



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



KRYETARI I KOMUNËS

14-030/01-181839/22, më 29. 07. 2022

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, me 28/04, qershor 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M

1. MIRATOHET Vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016.
2. Sipas pikës I të këtij Vendimi, plotësim ndryshimi nënkupton themelimin e Sektorit për çështje të kategorive të dala nga lufta e UÇK-së, e cila do të funksionoj në kuadër të Kabinetit të Kryetarit.
3. Sipas pikës II të këtij Vendimi, Zyra për çështje të kategorive të dala nga lufta e UÇK-së përbëhet nga Udhëheqësi i Sektorit, cili i raporton Kryetarit të Kryeqytetit dhe tre (3) zyrtar administrativ, ndërsa detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës, janë:
 - 3.1. Përfaqëson dhe promovon të drejtat e kategorive të dala nga lufta siç janë: veteranët, invalidët dhe familjet e dëshmorëve të UÇK-së.
 - 3.2. Trajtimi i kërkesave dhe nevojave për kategoritë e dala nga Lufta në territorin e Komunës së Prishtinës, përfshirë trajtimet shëndetësore kolektive dhe individuale si dhe rehabilitimin e kategorive të përfshira në ligj;
 - 3.3. Bashkëpunimi me ZÇKDL të UÇK-së në Kryeministrit dhe ministrin përkatëse MPMS dhe DFDIL.
 - 3.4. Koordinimi i aktiviteteve të Komunës së Prishtinës me rastin e organizimit të “Epopesë së UÇK-së”, “18 Prilli dita e dëshmorëve të komunës së Prishtinës”, “11 Qershori dita e çlirimit të komunës së Prishtinës”, “Ditës së Veteranit” dhe të gjitha manifestimeve tjera që lidhen me Luftën e UÇK-së si dhe përcaktimi i kalendarit vjetor të datave përkujtimore;

- 3.5. Bashkërendimi i aktiviteteve për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së të përcaktuara me ligj;
- 3.6. Bashkëpunimi me Organizatat e dala nga lufta, OVL, SHIL, SHFD të UÇK-së, degët në Prishtinë për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të kategorive të përcaktuara me Ligjin përkatës, si dhe aftësimin e të gjithave aktiviteteve që lidhen me luftën e UÇK-së.
- 3.7. Hulumentimi, ndërmjetësimi dhe nxitja e punësimit për kategoritë e dala nga Lufta e UÇK-së dhe familjarëve të tyre.
- 3.8. Zgjidhjen e çështjes së banimit të këtyre kategorive ashtu siç është e përcaktuar me ligj.
- 3.9. Propozimi i kërkesës për ndarje buxhetore për funksionimin e zyrës si dhe realizimin e projekteve të propozuara;
- 3.10. Krijimi i lehtësirave të ndryshme dhe ndarja e granteve dhe subvencioneve për zhvillimin e veprimtarive të veteranëve dhe invalidëve luftëtar si dhe lehtësira të ndryshme administrative dhe tatimore.
4. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale nr. nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale me nr. 14-031/01-0112491/22 i dt. 20.05.2022.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U DORËZOHET:

- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS
Përparim Rama

